



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:120623

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737632

**C.nr.337/20**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.H., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sh.M., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensim dëmi, vlera e kontestit 4,900.00 Euro, jashtë seance, me datë **21.05.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSIDEROHET** e tërhequr padia me numër C.nr.337/20, e paditësit E.H., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kompensim dëmi.

**A r s y e t i m**

Paditësi E.H., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datë 21.05.2024, në të cilën nuk kanë prezantuar asnjëra nga palët, edhe pse nga fletkthesat në shkresat e lëndës vërtetohet se palët, respektivisht përfaqësuesit e tyre, ftesat për seancën i kanë pranuar me rregullt, ndërsa mungesën nuk e kishin arsyetuar, prandaj, gjykata padinë e paditëses e konsideroi të tërhequr.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 409 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C.nr.337/20, të datës 21.05.2024**

Gjyqtari  
Nderim Musa

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.